

KËRKESË
Nr. 303/8, datë 6.10.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i Sheshit Rekreativ Shtërmën’, Bashkia Cërrik”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 1,312,282 (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Cërrik.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

- Për pasurinë “ndërtesë”, është bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Cërrik, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,312,282 (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA
PROJEKTI “NDËRTIMI I SHESHIT REKREATIV SHTËRMEN”, BASHKIA ÇËRRIK

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore									Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)									
													Tfuall			Ndërtesë			Vlera totale (lekë)			
	Emër	Atësi	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Tfuall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volum	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)		Vlera (lekë)		
	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	Q	R	S	T	U	V	X		
1	Albert	Lefi	Braka	Shtërmën	3422	101/38	Ndërtesë	227.5	0	0	227.5	21	127	0	0	0	227.50	5,425.53	1,234,309	1,234,309		
2	Albert	Lefi	Braka	Shtërmën	3422	101/37	Tfuall	227.5	0	227.5		21	126	227.5	282	64,155				64,155		
3	Arben	Kovi	Calja	Shtërmën	3422	101/39/1	Tfuall	350	0	49		22	155	49	282	13,818				13,818		
4	Shtet			Shtërmën	3422	101/11	Tfuall	64			64	2	85			0			0	0		
5	Shtet			Shtërmën	3422	101/39/4	Tfuall	4233.15				24	52			0			0	0		
6	Shtet			Shtërmën	3422	101/1/2	Ndërtesë	292				22	146			0			0	0		
Shuma																				1,312,282		